

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. LUAN DERVISHI

11/26/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 23.11.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 26.11.2018 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Luan Dervishi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Etleda Çiftja relatore, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.